



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 68, datë 6.2.2026

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.769, DATË 15.7.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STATUTIT
TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
(AMSHC)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr.10093, datë 9.3.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lidhjet nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur vendimit nr.769, datë 15.7.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)", të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Ngarkohet Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A

STRUKTURA E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE



ORGANIKA E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

POZICIONI	KLASA	NUMRI
1 DREJTOR EKZEKUTIV	I-3	1
SEKRETAR		1
2 SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PROGRAMEVE TË GRANTEVE DHE ZHVILLIMIT RAJONAL		3
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
SPECIALIST	IV-2	2
3 SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE, BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE KOMUNIKIMIT		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
SPECIALIST	IV-2	3
4 NJËSIA PËR SEKRETARIATIN E KKSHC-SË		3
SPECIALIST (PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË)	IV-2	1
SPECIALIST (PËR DRAFTIM DHE PËRGATITJE MATERIALESH)	IV-2	1
SPECIALIST (ARKIVIM DHE KOMUNIKIM)	IV-2	1

POZICIONI	KLASA	NUMRI
5 SEKTORI I FINANCËS DHE KONTROLLI I BRENDSHËM		4
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
INSPEKTOR	IV-1	1
SPECIALIST	IV-2	1
MAGAZINIER		1
PUNONJËS GJITHSEJ		16

NR.PROT. 230/2
DATË 6.2.2026

KRYEMINISTRISË
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

